

20151293770

L I G J

PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR OBLIGIMET SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR MBINDËRTIM DHE ZHVILLIM TË RRUGËVE, QË DO TË NËNSHKRUHET NDËRMJET BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM – BANKËS BOTËRORE DHE NP PËR RRUGË SHTETËRORE

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton pagimin e obligimeve dhe përmbushjen e dispozitave të Marrëveshjes për hua, që do të nënshkruhet ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore dhe NP për Rrugë Shtetërore në shumë prej 83 000 000 euro, në afate dhe kushte të parapara në Marrëveshjen për hua, nëse NP për Rrugë Shtetërore nuk i plotëson dhe servison obligimet nga Marrëveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen me Marrëveshje për hua, që do të lidhet ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore dhe NP për Rrugë Shtetërore për financimin e Projektit për mbindërtim dhe zhvillim të rrugëve.

Neni 3

Të gjitha obligimet që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do t'i kryejë NP për Rrugë Shtetërore nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua.

Neni 4

Afati për pagimin e huas nga neni 1 i këtij ligji është 28 vite, me grejs periudhë të përfshirë prej 8 vitesh.

Shkalla e kamatës është EURIBOR gjashtëmujor plus shtrirja variabile.

Në ditën e tërheqjes së mjeteve të huas, NP për Rrugë Shtetërore do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore provizion të njëhershëm në shumë prej 0,25% të shumës së huas.

NP për Rrugë Shtetërore do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore taksë për obligueshmëri-shpenzim në shumë prej 0,25% në vit, për shumën e patërhequr të huas (Commitment charge). Taksa për obligueshmëri do të paguhet në gjysmëvit në çdo datë të pagimit.

Huaja do të paguhet në mënyrë semestrale, në çdo 15 maj dhe 15 nëntor të vitit.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella që dalin nga Marrëveshja për hua dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe NP për Rrugë Shtetërore do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë".